



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Senati Akademik

Nr. 1124 Prot

Shkodër, më 29 . 03 .2024

V E N D I M

Nr. 91 datë 29.03 2024

**"PËR MIRATIMIN E SHPËRBLIMIT PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS NË
UNIVERSITETIN E SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**


Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në RSH", i ndryshuar; VKM nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor". udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar, VKM nr. 834, datë 28.12.2023 "Për një ndryshim në Vendimin nr.929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë". të ndryshuar, dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa institucione", pika 1, gërma "a", Senati akademik në mbledhjen e datës 29.03.2024

Vendosi

1. Të miratojë shpërblimin për punonjësit mbështetës të cilët paguhen me sistemin me 9 dhe 13 klasa në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim përfundimtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Rajmonda Këçira





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Senati Akademik

Nr. 1124 Prot

Shkodër, më 29 . 03 .2024

Lënda: Relacion shoqërues i Vendimit të Senatit Akademik nr. 91, datë 29.03.2024 "Për miratimin e shpërblimit për punonjësit mbështetës në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

Senati akademik ka analizuar në mbledhjet e tij të datave 28.02.2024 dhe 29.03.2024 kërkesën e punonjësve mbështetës të USH-së lidhur me shpërblimin e tyre si e drejtë e fituar nga VKM nr. 834, datë 28.12.2023 " Për një ndryshim në vendimin nr 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar dhe për shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa instiucione", e pazbatuar nga administrata e USH-së brenda afatit ligjor të parashikuar në VKM-në në fjalë.

Nga analiza e rastit ka rezultuar se VKM nr. 834, datë 28.12.2023 " Për një ndryshim në vendimin nr 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar dhe për shtesë fondi në Buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa instiucione" i ka dhënë të drejtë punonjësve mbështetës të cilët paguhen me sistemin 9 dhe 18 klasa, të shpërblehen në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe ka ngarkuar institucionin tonë që të kryejë veprimet financiare për zbatimin e këtij vendimi deri me datën 15.01.2024. Rezultoni gjithashtu që Administrata e USH-së nuk ka vepruar as në kohë e as në kuptimin e drejtë të parashikimeve të VKM-së nr. 834, datë 28.12.2023 duke sjellë si pasojë mosgarantimin e të drejtës së fituar për punonjësit mbështetës të USH-së, kategori e cila ka pagat më të ulëta në të gjithë stafin e USH-së.

Ndërkohë rezultoni që universitete të tjera si Universiteti "I.Qemali", Vlorë, Universiteti Politeknik, Universiteti i Sporteve, etj. ka proceduar me pagesën e shpërblimit për punonjësit mbështetës sipas VKM-sw nr. 834 datë 28.12.2024.

Nga ana tjetër, sipas parashikime të dispozitave të Kodit të Punës në RSH, punëmarrësi ka të drejtë t'i kërkojë brenda tre viteve, të drejtat ekonomike financiare që fiton në kuadër të marrëdhënies së punës.

Nisur nga sa më sipër, Senati akademik, në përfundim të shqyrtimit të rastit vendosi të miratojë shpërblimin e punonjësve mbështetës të cilët paguhen me sistemin 9 dhe 18 klasa, të shpërblehen në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, shumë e cila të mbulohet nga të ardhurat e USH-së dhe t'i kërkojë Bordit të Administrimit miratimin përfundimtar të këtij vendimi.

KRYETARE E SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. ~~Rapnonda Këgjira~~

